



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, LEGJISLACIONIT DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1299 Prot.

Patos, më 17/04 2026

NJOFTIM

**Dëgjese publike me temë:
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare për hartimin e PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**

Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 83, datë 17.12.2025 “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2027”.

Ju njoftojmë se:

1. Ditën e **Martë** në datë **19.05.2026 ora 10:00**, në ambientet e njësisë administrative Zharrëz do të organizohet takimi konsultativ me përfaqësues të: anëtarë të Këshillit Bashkiak, kryetarë të fshatrave, banorë të njësisë administrative, shoqëri civile dhe grupe interesi, përfaqësues të bashkisë Patos dhe njësisë administrative, me temë: **“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare për hartimin e PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**.
2. Ditën e **Mërkurë** në datë **20.05.2026 ora 10:00**, në sallën e Këshillit Bashkiak Patos do të organizohet takimi konsultativ me përfaqësues të: anëtarë të Këshillit Bashkiak; kryetarë të fshatrave; grupe interesi; banorë të zonës; shoqëri civile; përfaqësues të bashkisë Patos, me temë: **“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare për hartimin e PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**.
3. Ditën e **Premte** në datë **22.05.2026 ora 10:00**, në ambientet e njësisë administrative Ruzhdie do të organizohet takimi konsultativ me përfaqësues të: anëtarë të Këshillit Bashkiak, kryetarë të fshatrave, grupe interesi, banorë të njësisë administrative Ruzhdie, përfaqësues të bashkisë dhe njësisë administrative, me temë: **“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare për hartimin e PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**.

Këto konsultime publike synojnë realizimin e një procesi transparent mbi rishqyrtimin e kërkesave prioritare lidhur me hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetit 2027 në tre njësitë administrative Patos, Ruzhdië dhe Zharrëz.

Komentet dhe rekomandimet e grupeve të interesit janë të mirëpritura, brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik në adresën e email-it: info@bashkiapatos.gov.al.

Pjesëmarrja juaj në këtë dëgjese publike është shumë e rëndësishme për garantimin e një procesi sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.

KRYETARI
Fation Duro

